

Vizioni ynë

Synimi ynë është t'u ofrojmë njerëzve në nevojë arsimim, ndihmë psiko-sociale dhe humanitare, ose shërbime të tjera që konsiderohen të nevojshme. Ne duam të ndikojmë në jetën e tyre duke i ndihmuar ata të dalin nga varfëria dhe të sigurojnë veten.

Ne besojmë se jeta në komunitet, lidhja dhe miqësia janë faktorë shumë të rëndësishëm dhe duam t'i forcojmë këto vlera në komunitetet ku punojmë. Prandaj, ne gjithashtu bashkëpunojmë me administratën lokale, shkollat, kishat, organizatat e shoqërisë civile dhe nisma të tjera lokale.

Dhuroni për projektet

→ Behu sponsor projekti:

Dhurimi juaj i rregullt do të jetë një kontribut i vlefshëm për të pasur një bazë të shëndoshë për shpenzimet tona të funksionimit. Në terma afatgjatë, 20, 30 ose 50 Euro në muaj tashmë do të kenë një efekt të madh!

→ **Qëndroni të informuar** me informacionet më të fundit në internet ose publikimet tona

→ **Bëhu pjesëmarrës** duke marrë pjesë në projektet apo udhëtimet tona misionare

Për më shumë informacion mund të kërkonti online ose të kontaktoni zyrën tonë.



Puna e Diakonia Albania dhe CHW

Fondacioni Diakonia Albania shërben si një organizatë jofitimprurëse për njerëzit në nevojë. Ajo na çon pas në kohë, pikërisht në punën shumë-vjeçare të Shoqatës së Krishterë për Ndhimë në Wismar (CHW) Gjermani, e cila në 1992 udhëtoi drejt Pogradecit me ndihmat e para.

Diakonia Albania, e themeluar në vitin 2012 organizon shërbimet dhe projektet në zyrat e Tiranës dhe Pogradecit. Ne bashkëpunojmë me kishat, administratat dhe organizatat e tjera të ndihmës, dhe me vullnetarë nga Shqipëria, Gjermania dhe vende të tjera.

30 vjet punë kanë sjellë shumë bekime. E megjithatë ka shumë për të bërë.



Foto: Valbona Balla, Aurora Zeqo, Fatjon Pjetri dhe të tjerë Design: Studio2.de



Projekte sociale në Shqipëri

Ndihma humanitare, qender femijesh dhe shërbime komunitare: Ne ndihmojmë njerëzit në nevojë me ndihmë emergjente si dhe me projekte afatgjata. Bashkohuni me ne!

Fondacioni Diakonia Albania (DA)

Rruga 5 Maj, Concord center, Tirana
Telefoni: +355 (0) 83-22 87 51
E-mail: info@diakonia.al

Zyra Pogradec:
Rr. Mihal Ballkameni, 7301 Pogradec
www.diakonia.al

Llogaria e dhurimit:
NIPT: L21423453S
Banka Kombëtare Tregëtare
SWIFT-BIC: NCBAALTX
IBAN: AL09 2054 2146 0022
88CL TJCF EUR

Anëtar i Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë (VUSH)

Ndihma e nevojshme

Pavarësisht progresit të dukshëm, ka ende shumë varfëri në Shqipëri – edhe në qytete, por veçanërisht në zonat rurale. Nuk ka pothuajse asnjë punë atje, dhe shteti nuk ka burime për të siguruar rrugë, shkolla, etj. Kjo është arsyeja pse autoritetet janë shumë mirënjohëse për shtimin e punës sonë sociale.

Për më shumë se 30-vjet ne jemi aktivë në zonën e Mokrës në Juglindje të Shqipërisë, dhe prej vitesh edhe në qytetin e Pogradecit, Librazhdit, Lezhës, Tiranës. Projektet tona sociale u drejtohen atyre që kanë vërtet nevojë për ndihmë: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet në nevojë. Për ta, çdo mbështetje, sado e vogël, paraqet një përmirësim të dukshëm.

Qendra fëmijë në Bishnicë

Në qendrën tonë fëmijët kanë një fillim të mbarë në jetë. Shumica e tyre jetojnë në shtëpi banimi gjatë javës dhe ndjekin shkollën e fshatit në Bishnicë; ata gjithashtu marrin mbështetje individuale për të mësuar dhe kurse shtesë nga stafi ynë. Si nivel i dytë, ne kujdesemi për fëmijët me nevoja të veçanta që jetojnë përgjithmonë në qendrën tonë.

Shërbimet tona për fëmijët përfshijnë: ushqim, veshëmbathje, aktivitete në kohën e lirë, materiale shkollore, kujdes higjiene, shërbim shëndetësor dhe dentar, këshillim psiko-social etj.

Ushqimi, strehim dhe edukimi për një fëmijë:
150 € / 20.000 Lekë për muaj

Faqja e projektit
www.chwev.de/al/qender-femijesh



Nxënësit në qendrën e fëmijëve janë të lumtur për mundësinë që të mund të shkojnë në shkollë dhe të mësojnë

Shërbime komunitare

Për mbi 15 vjet, infermieri Bashkim Lilo kujdeset për të sëmurët dhe ata që kanë nevojë për kujdes nga Bishnicë; atij i bashkohet mbështetja psiko-sociale nga punonjësi ynë social. Në këtë mënyrë ne ofrojmë ndihmë që sistemi shëndetësor shtetëror nuk mund t'i japë. Ne gjithashtu do të donim të punësonim një infermiere – nevoja është atje.

Faqja e projektit
www.chwev.de/al/sherbime-komunitare

Vizita javore tek një person apo familje:
50 € / 7.000 Lekë për muaj

Materiale mjekësore dhe higjiene:
20 – 30 € / 2.500 – 4.000 Lekë për muaj



Mbështetje dhe këshilla për familjet e varfra pranë Velçanit

Ndihme humanitare

Ndihma jonë humanitare përfshin një sërë aktivitete. Në bashkëpunim me qytetin e Pogradecit dhe bashkitë e tjera, punonjësit e Diakonia Albania shpërndajnë ushqime, pako familjare si dhe produkte higjiene dhe kujdesi për personat e moshuar, të sëmurë dhe me aftësi të kufizuara me familjet e tyre.

Ndihma jonë humanitare përfshin edhe aktivitete në kriza dhe pas fatkeqësive. Këtu, rrjeti ynë në Gjermani dhe Shqipëri është po aq i rëndësishëm sa infrastruktura e Diakonia-s me staf dhe vullnetarë, automjete dhe magazina në Pogradec.

Pakot ushqimore:
60 € / 8.000 Lekë secila
Pako më veshje: **25 € / 3.000 Lekë**
Magazinat Wismar dhe Pogradec:
700 € / 100.000 Lekë për muaj

Faqja e projektit
www.chwev.de/al/ndihme-humanitare